



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA RREGULLATORE  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 18840 prot.

Vlorë, më 20.11 2024

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PËR**

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA  
DJEGIA E BANESËS TË Z.NURO BLUSHAJ DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR  
NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z. Nuro Blushaj, e ndodhur në lagjen “Ura e Izvorit”, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, në datën 13.07.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 151.053 (njëqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e tre) lekë për punime ndërtimi (302.107x50%).



B. 561.858 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë etetëqind e peëdhjetë e tetë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Financë-Buxhetit dhe Drejtorja e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLERË  
DREJTORIA RREGULLATORE  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 18840 prot.

Vlorë, më 20.11 2024

RELACION

PËR

**PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z. NURO BLUSHAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLERË “**

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 26.07.2024 ka paraqitur kërkesën z.Nuro Blushaj me nr.11894prot. për shkakë të djegies së banesës e ndodhur në lagjen “Ura e Izvorit” Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.15 datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 29.07.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.11894/1 prot, datë 13.09.2024 ‘‘Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z. Nuro Blushaj në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.11894/2 prot, datë 26.09.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z. Nuro Blushaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Nuro Blushaj është 712.911 (shtatëqind e dymbëdhjetë e nëntëqind e njëmbëdhjetë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z. Nuro Blushaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

**DREJTOR**

**Dorian Demiri**

